

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË "Softing Tech" SHPK**

Sot më datë 12.04.2022, palët e mëposhtme:

- **Z. Andi Ndreçka**, i biri i Ardjan Ndreçka, i datëlindjes 10.09.1997, lindur në Tirane dhe banues në Tirane dhe
- **Z. Ergys Begolli**, i biri i Eduard Begolli, i datëlindjes 12.10.1999, lindur në Hamburg dhe banues në Tirane

shprehin vullnetin e tyre për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë "Softing Tech" sh.p.k. si më poshtë vijon:

**1. Forma ligjore e shoqërisë**

Shoqëria "Softing Tech" Shpk, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar", shkurtimisht SHPK.

**2. Ortakët themelues**

Shoqëria është themeluar nga Ortakët e mëposhtëm:

- Z. Andi Ndreçka
- Z. Ergys Begolli.

**3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i aktivitetit të shoqërisë "Softing Tech" sh.p.k. do të jetë:

- Zhvillim web
- Zhvillim mobile
- Zhvillim dhe analiz sistemesh
- Konsultim teknologje
- UX design
- Zhvillim strategje marketingu dixhital

#### **4. Selia e shoqërisë**

Selia e Shoqërisë “Softing Tech” sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën: Rr. Kavajes, nr. 50, Coolab Tirana.

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

#### **5. Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papercaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

#### **6. Kapitali i shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “Softing Tech” sh.p.k. është 1000 Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontributë në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të Shoqërisë në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt notarial.

#### **7. Drejtimi dhe Administrimi**

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “Softing Tech” sh.p.k. është **Z.Andi Ndreçka**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “Softing Tech” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kusifice që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqerinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

#### **8. Shpërbërja dhe likuidimi**

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjeter që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

### Ortakët


Andi Ndreçka

Andi Ndreçka



Ergys Begolli

Ergys Begolli



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "John Doe".